ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 12/17
Datë/Datum. 16.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Për: KK Prishtinë

Për Aktivitetin e Prokurimit: 616 16 144 121

Sa i përket tenderit për: Furnizimi me 4 (katër) aparate automatike për nxjerrjen e dokumenteve të gjendjes civile – E Kiosk.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit

PBC sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Hamdi Mramori nr. 1

(Adresa)

Prishtine — 10 000

(Vendi) — *(Kodi postar)*

038 600 200 — N/A

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Bashkim Selmani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bashkim@pbc-ks.com

(Adresa elektronike)

16.01.2017

(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

pbc SH.P.K.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

(Emri i avokatit)

N/A

(Adresa e plotë)

N/A

(Numri i Telefonit)

N/A

(Numri i faks-it)

N/A

(Adresa elektronike)

N/A

(Data e parashtrimit të kërkesës)

N/A

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë:	13.09.2016
Afati për dorëzimin e tenderëve:	03.10.2016
Data e vazhdimit te afatit:	29.09.2016
Afati i dorëzimit të tenderëve:	14.10.2016
Data e dorëzimit të Kërkesës për Shqyrtim:	08.10.2016
Data e dorëzimit të ankesës në OSHP:	13.10.2016
Data e ekspertizës nga OSHP:	31.10.2106
Data e vendimit të OSHP:	07.11.2016
Data e korrigjimit të gabimit nga AK:	29.11.2016
Data e Kërkesës për Informata shtesë:	03.12.2016
Data e Kërkesës për ri-Shqyrtim:	11.12.2016
Data e shtyerjes së afatit nga AK:	29.12.2016
Data e Kërkesës për Ri-shqyrtim - I:	04.01.2017
Data e rikujtesës për Ri-Shqyrtim - II	08.01.2017
Kriteri për dhënien e kontratës:	Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. **Procesi i Hapjes së tenderëve**, *nëse aplikohet*
A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☐

Nuk jemi në dijeni nëse është bërë pranim ose hapje të ofertave nga Autoriteti Kontraktues. Ne nuk kemi dorëzuar ofertë, pasi që kemi qenë në pritje të 'ri-shqyrtimit të vendimit', të cilin e kemi dërguar së paku dy (2) herë e nuk kemi pranuar asnjë përgjigje.

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve**, *nëse aplikohet*
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ Jo ☒

6. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**
Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Supozojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur: - Nenin 1 i Ligjit për Prokurim Publik, - Nenin 7 i Ligjit për Prokurim Publik, - Nenin 28 i Ligjit për Prokurim Publik, - Nenin 53 i Ligjit për Prokurim Publik, - Nenin 108/A i Ligjit për Prokurim Publik - Paragrafin 8 të Nenit 118 të Ligjit për Prokurim Publik

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

1. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur **nenin 1** të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Paragrafin e 4'të të nenit 18 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, **SEPSE:**

    a. Autoriteti Kontraktues ka udhëhequr këtë procedurë jashtë etikës profesionale, jashtë integritetit dhe ka shpërdoruar rrënjësisht përgjegjësitë që ka ndaj fondeve publike dhe operatorëve ekonomik.
    Provë: Sjellje iracionale dhe këmbëngulëse gjatë gjithë procedurës së prokurimit. Shih korrespodencat.

2. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur **nenin 7** të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Paragrafin e 4'të të nenit 18 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, **SEPSE:**

    a. Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar barabarësisht të gjithë operatorët ekonomik dhe ka ekzekutuar aspekte të prokurimit që kanë reduktuar ndjeshëm konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik.
    Provë: Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë përgjigjet (informacionet shtesë) të domosdoshme për të definuar qartë subjektin e kontratës dhe fushëveprimin e angazhimit të operatorëve ekonomik. Kjo ngjallë dyshime serioze se dikujt nga Operatorët Ekonomik, i janë dhënë informatat e plota, në mënyrë jo zyrtare, ndërsa neve, përkundër që të njëjtat i kemi kërkuar dhjetëra herë nuk na janë dhënë.

3. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur **nenin 28** të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Paragrafin e 4'të të nenit 18 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, **SEPSE:**

    a. Autoriteti kontraktues nuk i ka përpiluar specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.
    Provë: Ka kërkuar funksione të padefinuara në shkallën minimale të realizimit, ka kërkuar produkte dhe pajisje që iu përgjigjen vetëm prodhuesve specifik dhe i diskriminojnë të tjerët – shih 'Kërkesën për Informacione shtesë' nga ana jonë.

4. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur **nenin 53** të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Paragrafin e 4'të të nenit 18 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, **SEPSE:**

    a. Autoriteti Kontraktues nuk na ka dhënë informacione plotësuese, edhe pse të njëjtat i kemi kërkuar dhjetëra herë. As nuk ka konstatuar se informacione të tilla janë të panevojshme, siç përkufizohet në Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik.
    Provë: Shih Kërkesën për Informacione shtesë dhe Kërkesën për Ri-Shqyrtim të vendimit. Për ato që janë me ngjyrë të kuqe nuk kemi pranuar përgjigje.

5. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur **nenin 108/A** të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Paragrafin e 4'të të nenit 18 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, **SEPSE:**

   a. Autoriteti Kontraktues nuk e ka marrë fare parasysh 'Kërkesën për Ri-Shqyrtim të Vendimit' të dërguar nga ana jonë dy (2) herë, as nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit e as nuk i ka shqyrtuar ato e as nuk na ka kthyer përgjigje.
   Provë: Shih shkresat tona (dt. 04.01.2017 dhe 08.01.2017) dhe konfirmimin e pranimit të tyre nga Autoriteti Kontraktues (05.01.2017 dhe 10.01.2017)

6. Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur **paragrafin 8 të nenit 118** të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Paragrafin e 4'të të nenit 18 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, **SEPSE:**

   a. Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuat vendimin e OSHP'së numër 360/16, pasi që, pëkundër se aty thuhet që të respektohet ekspertiza e ekspertëve shqyrtues, e në ekspertizë thuhet të mos kërkohet mostra e eKioskës – prezantimi is saj, ndërsa Autoriteti Kontraktues ka në Dosjen e tenderit e ka kërkuar atë, në mënyrë decidive.

Prandaj, bazuar në këto që u thanë më sipër, fuqishëm konstatojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshti me dispozitat ligjore, të theksuara më sipër dhe kërkojmë që ky proces i prokurimit të **RITENDEROHET** dhe të riniset një procedurë që garanton barazi dhe integritet ndërmjet operatorëve ekonomik.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Pamundësia e pjesëmarrjes në këtë procedurë prokurimi, përkatësisht implementimit potencial të kësaj kontrate, kompanisë sonë i pamundësohet profiti monetar në vlerë prej hiç më pak se 3,800.00 EUR.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) Kopja e publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
b) Kopja e ankesës paraprake,
c) Kopja e Ekspertizës,
d) Kopja e vendimit të OSHP'së
e) Kopja e Kërkesës së parë për informacione shtesë
f) Kërkesa e parë për Rishqyrtim (dt. 11.12.2016)
g) Vendimi i Autoritetit Kontraktues për Kërkesën për Rishqyrtim,
h) Vazhdimi i afatit për dorëzimin e ofertave,
i) Përgjigjet (e vjetra) të Autoritetit Kontraktues,
j) Kërkesa e dytë për Ri-shqyrtim të Vendimit (dt. 04.01.2017)
k) Konfirmimi (Automatik) i pranimit të Kërkesës për Rishqyrtim
l) Kërkesa e tretë për Ri-shqyrtim të Vendimit (dt. 08.01.2017)
m) Konfirmimi (Automatik) i pranimit të Kërkesës për Rishqyrtim
n) Kopja e pagesës se tarifës se ankesës